

NJË STUDIM I THELLUAR SHKENCOR DHE PËRMBAJTËSOR MBI SHEKUJT E PARË TË SUNDIMIT USHTARAK, ADMINISTRATIV DHE EKONOMIK OSMAN NË KOSOVË

(Masar Rizvanolli, *Vendosja e sistemit të timarit në Kosovë në gjysmën e dytë të shekullit XV*, Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri”, 2021, 680 f.)

Studimi monografik “Vendosja e sistemit të timarit në Kosovë në gjysmën e dytë të shekullit XV”, është një trajtim i thelluar që përfshinë një nga problematikat e rëndësishme ekonomike dhe shoqërore të Kosovës nën sundimin osman në gjysmën e dytë të shekullit XV - atë të sistemit timar, sistem ky, i cili filloi të shthuret, qysh nga mesi i shek. XVI. Në të ndriçohen problemet e vendosjes së pronës shtetërore në tokat shqiptare gjatë shek. XV-XVI, varësinë feudale dhe një pjesë të rentës që lidhej me të, strukturën shoqërore etj.

Monografia e historianit prof. dr. Masar Rizvanollit, është në thelb, një variant i përpunuar dhe redaktuar i studimit të lënë në dorëshkrim, me të cilën ai mbrojti me shumë sukses tezën e doktoratës dhe mori (në vitin 1990) gradën e doktorit të shkencave. Për rrjedhojë, ky libër është një krijesë shkencërisht e certifikuar, vepër e një studiuesi të talentuar, të formuar e jashtëzakonisht kërkues.

Qasja tërësore, gjithëpërfshirëse, që autori ka zgjedhur për të përfituar rezultatin historik të zbatimit të sistemit spahinjsh e timarësh osmanë të shek. XV-XVI, i ka imponuar atij përcaktimin, gjithashtu, të një kuadri të plotë gjeografik, duke përfshirë në analizën e vet një pjesë të konsiderueshme të trojeve shqiptare, që aso kohe njësoheshin me provincat administrative osmane. Kështu, autori merr në trajtim një territor të gjerë ku bënin pjesë shqiptarët përmes njësive administrative gjatë kohës së pushtimit osman, e cila përfshinte vilajetin e Kosovës (vilajeti Vëlk), apo sanxhaqet e Vuçitërnës, Shkupit, Prizrenit, Shkodrës, Dukagjinit, dhe më gjerë që përbënin një trevë të përbashkët ekonomike, shoqërore e kulturore. Në monografi, nuk mungon shfrytëzimi i një dokumentacioni arkivor të gjerë dhe të pasur nga provinca Lindore (osmane) e Perëndimore, në mënyrë të veçantë i kanunnameve osmane, si dhe një literature relevante të specializuar mjaft të pasur. Vëmendjes dhe

vlerësimet të tij nuk i ka shpëtuar asnjë burim dokumentar, asnjë autor relevant, gjë që flet për një përgatitje dhe afinitet të veçantë me gjuhët e huaja të përmendura. Rëndësi të madhe në këtë drejtim kanë përdorimi i botimeve të akteve legjislative të karakterit të përgjithshëm për Perandorinë Osmane dhe ato për vendet ballkanike, midis tyre edhe për trevat shqiptare, si: kanunnamea e sulltan Mehmetit II, kannunamet e periudhës së sundimit të Selimit I dhe ato të Sylejman ligjvënësit.

Për të plotësuar aspektin e studimit më të kompletuar mbi vendosjen dhe zbatimin e drejtpërdrejtë të sistemit timar në Kosovë, autori ka përdorur edhe defterët kadastralë të përmbledhur dhe të hollësishëm të tokave në pronësi të feudalëve të veçantë (mylk) dhe të institucioneve fetare (vakëf), etj. Ndër këto, më kryesore duhet përmendur Defterin e përmbledhur të sanxhakut shqiptar (Sancak-ı Arvanid) i viti 1431, Defterin e hollësishëm të vilajetit të Kosovës (Vëlk apo Vuk Brankoviçit) i vitit 1455, Defterin e hollësishëm të sanxhakut të Shkodrës të vitit 1485, Defterin e përmbledhur të sanxhakut të Vuçitërnës e të Prizrenit të viteve 1530-‘31, etj. Në njohjen e këtyre dokumenteve përmes botimeve të tyre, kontribut të çmuar kanë sjellë turkologë të vendeve të ndryshme, si: A. Tveritina, M. F., Köprülü, H. Hadžibegić, H. Šabanović, G. Gălăbov, A. Novičev, St. Novaković, N. Filipović, O. Zirojević, B. Cvetkova, Ö. Lütfi Barkan, H. İnalçık, F. Babinger, J. Hammer, A. Handžić, G. Elezović, B. Đurđev, si dhe studiuesit shqiptarë të periudhës osmane: J. Kabrda, S. Pulaha, H. Kaleshi, S. Rizaj, I. Rexha, etj.

Bazuar në tematikën e studimit, autorit i është dashur të përdorë një terminologji shkencore të emërtimeve të kohës, e cila ka origjinë osmane, turke, arabe, frënge, sllave etj. Në të shumtën e rasteve, përdorimi i tyre ka qenë i paevitueshëm, andaj është bërë përpjekje që domethënia e këtyre emërtimeve të tilla të shqipërohet, zërthehet dhe të sqarohet në tekst apo në referenca.

Defterët e shek. XV dhe XVI tregojnë se spahinjët e Kosovës ishin kryesisht të vendit, feudalë të islamizuar, në mesin e të cilëve kishte shumë shqiptarë. Megjithatë, nuk mungonin edhe spahinjët e krishterë. Kështu në defterin e Kosovës (Vëlk) të vitit 1455, prej 170 timareve, 27 i takonin spahinjve të krishterë, dhe dhjetë prej tyre ishin regjistruar si “spahi të moçëm”. Veprimet e para që kryen osmanët për vendosjen e regjimit ekonomik, shoqëror e politik të tyre ishte shpronësimi i klasës feudale shqiptare nga toka. Ky proces u krye për një periudhë gati njëshekullore, (gjatë shek. XV), sipas fazave që përdori pushteti, në saje të përdorimit të fuqisë ushtarake dhe të shumë masave e metodave tjera të

njohura osmane, të karakterit ekonomik, politik e ideologjik-fetar. Pra, siç është theksuar me të drejtë në historiografinë shqiptare, pronësia shtetërore mbi tokën u vendos vetëm pas një shkatërrimi të fuqisë ekonomike dhe prodhuese të vendit, e cila pengoi zhvillimin objektiv ekonomik të tokave shqiptare dhe për pasojë pati rrjedhje frenuese në zhvillim e mëvonshëm historik.

Zbatimi i pronësisë shtetërore osmane - *mirie* në Kosovë pati po atë përmbajtje edhe ato tipare që e karakterizuan edhe viset tjera të Perandorisë. Ajo u vu në jetë mbi të njëjtat parime, ligje e norma juridike. Megjithatë, rruga që përshkoi procesi i vendosjes dhe shkalla e zbatimit të saj dallon nga ato të trevave të tjera, si rezultat i kushteve të ndryshme historike në të cilën ndodhen tokat shqiptare. Ky sistem u zbatua në gjerësi dhe thellësi, duke e bërë më intensiv regjimin e timarit. Nga ky sistem i pronësisë (haset, ziametet e timaret), timaret si njësi tokësore unike ishin forma më e përhapur e feudit osman dhe përfshinte pjesën më të madhe të ekonomive fshatare dhe të rentës spahiore të vjelë nga fshatarësia e Kosovës. Si kategori tokësore, timari ishte dirlik i kategorisë së tretë. Në sistemin timar, shumicën e pronave e përbënin tokat e punueshme bujqësore në përdorim të fshatarëve, të ndara në feude dhe të vendosura nën statusin e rajës mbi të cilin krijoheshin raporte ekonomike-shoqërore të caktuara midis spahinjve si sundues dhe fshatarëve raja, karakteristike për regjimin timar.

Libri është strukturuar në gjashtë kapitla, në atë mënyrë që tema bazë të jetë e mbuluar me periudhën pararendëse e pushtimit osman si dhe me pasojat që la në shoqëri ky pushtim. Në synim të kësaj, narrative e tij, autori fillon ta ndërtojë duke filluar me Kosovën në periudhën mesjetare, që sipas tij, gjatë mesjetës, Kosova nuk paraqiste një tërësi të caktuar në pikëpamje shoqërore, politike, ekonomike dhe kulturore. Shekuj me radhë ky territor ishte pjesë e pushtimeve të Perandorisë Bizantine, Bullgare dhe asaj Nemanjidase. Për pasojë, nga fundi i shek. XI, ajo u bë arenë luftimesh, sidomos kur drejtimi i fushatave pushtuese sllave ndaj Bizantit kalon nga Zeta në Rashë, kur kjo fushatë zhvillohej për zgjerimin e shtetit të Rashës në drejtim të jugut. Shndërrimi i Kosovës dhe Maqedonisë Perëndimore, në një arenë ngjarjesh shkaktojë pasoja afatgjate historike jo vetëm për banorët e saj, por edhe për vendet tjera ballkanike.

Fundi i shek. XIV, karakterizohet me fillimin e pushtimeve osmane në tokat shqiptare dhe përgjithësisht në Gadishullin Ballkanik. Përpjekjet e Stefan Dushanit për ta organizuar qëndresën kundër rrezikut osman dështuan pas vdekjes së tij më 1355. Pas vdekjes së Stefan

Dushanit (1355), në Rashë shpërthyen luftërat e brendshme për pushtet, të cilat rezultuan me shkëputjen e disa feudalëve të mëdhenj, duke krijuar zotërimet e tyre të pavarura. Kështu p.sh., në një pjesë të Kosovës dhe në Maqedoninë Perëndimore, u pavarësua sundimtari serb Vukashin. Pas vdekjes së këtij të fundit dhe të Stefan Uroshit I (1371), Kosova u bë pjesë e zotërimeve të sundimtarëve të tjerë, duke përfshirë familje bujare arbërore Balshajt, Dukagjinit dhe Kastriotët. Balshajt, të cilët që nga viti 1360 u shfaqën si sundimtarë të Zetës, Tivarit, Budvës, Shkodrës, Drishtit dhe Ulqinit, si bërthamë territoriale e shtetit të tyre, në saje të rrethanave të favorshme ekonomike dhe të mbështetjes që gjeti Gjergj I Balsha në krahinën e Kosovës, shteti i Balshajve u konsolidua për një kohë të shkurtër. Në vitin 1372, në kuadër të zotërimeve të Balshajve hynë disa qytete, si Prizreni, Prishtina, Peja, Trepça etj. Pas vdekjes së Gjergjit I, zotërimet e Balshajve në Kosovë hynë në kuadër të kryezotërinjve arbërorë në ngritje, të Dukagjinëve e Kastriotëve.

Sundimtarët e principatave feudale, që ishin krijuar mbi gërmadhat e Perandorisë Bizantine dhe të Perandorisë së Dushanit, gjatë grindjeve me njëri-tjetrin, ftonin shpeshherë, në ndihmë osmanët, të cilët e shfrytëzonin rastin për të vendosur pushtetin e tyre. Të pafuqishëm për të mbajtur pushtetin e tyre si të pavarur, një pjesë e tyre, me kalimin kohës u kthyen në vasalë të Perandorisë Osmane.

Pas Betejës së Maricës (1371) dhe asaj të Kosovës më 1389, ndonëse osmanët nuk e vendosën tërësisht pushtetin e tyre, megjithatë, vendosja graduale e sundimit osman kishte filluar të jetësohej.

Pas Betejës II të Kosovës (1448), Gjurgj Brankoviqi iu përkushtua konsolidimit të shtetit të tij, duke e zgjeruar atë deri në disa pjesë të Zetës. Njëherësh, ai kreu detyrën e tij si vasal, duke i dërguar kalorës sulltan Mehmetit II (1451-1481), që të merrnin pjesë në sulmin për pushtimin e Kostandinopojës. Megjithatë, pas pushtimit të qendrës së fundit të Bizantit (1453), Mehmeti II dyshonte në vasalin e tij, Gjurgj Brankoviqin, i cili kishte bërë një aleancë me Bullgarinë dhe dyshohej se kishte hyrë edhe në negociata me papën. Rrjedhimisht, në vitin 1454, sulltan Mehmeti II, e njoftoi despotin Gjurgj se, Rasha nuk ishte e tij, dhe se i takonte vetë sulltanit, që do të marshonte kundër despotit serb. Në pranverë të vitit 1455, Mehmeti II, në krye të një ushtrie të madhe, depërtoi në Kosovë dhe, meqë komandanti i Novobërdës refuzoi të dorëzohej, e vuri atë nën rrethim. Muret e saj u bombarduan nga artileria osmane për 40 ditë. Më në fund, më 1 qershor 1455 qyteti i Novobërdës, në bazë të një marrëveshjeje, iu dorëzua osmanëve. Më pas, ushtritë

osmane pushtuan Lipjanin, Prizrenin, Prishtinën, Trepçën etj. Me këtë, dypushteti serbo-osman në Kosovë mori fund, ndërsa u zëvendësua me atë osman.

Pra, deri më 1455, njëfarë pushteti i kufizuar osman u vendos në pika të rëndësishme të Kosovës (Trepçë, Prishtinë etj.) ku sundimtarët serbë vasalë të osmanëve, po ashtu ushtronin pushtetin e tyre, çka funksiononte një pushtet i dyfishtë.

Sipas autorit, me vendosjen e sundimit të tyre, osmanët e vendosën këtu edhe rregullimin shtetëror, shoqëror dhe ekonomik, sistemin e tyre administrativ dhe ndarjen e tyre administrative. Njësite më të mëdha administrative, në të cilat ndahej Perandoria Osmane, duke filluar nga periudha e sundimit të Muratit I dhe deri në kohën e reformave të Mahmutit II, ishin *ejaletet* ose *bejlerbejllëku*, apo, si quhen shpesh, *pashallëqet*. Ejaletet ndaheshin në njësi më të vogla administrative, në *saxhaqe* ose *liva*, në krye të të cilave qëndronte sanxhakbeu. Sanxhaqet ndaheshin në njësi më të vogla, në kaza ose kadilleqe, në nahije, etj. Si njësi gjyqësore dhe administrative funksionet gjyqësore, administrative edhe fetare në kaza i kryente kadiu, ndërsa rendin dhe qetësinë e mbante subashi. Në krye të këtyre institucioneve qëndronte një aparat i tërë administrativ dhe fetar.

Në përputhje me sistemin administrativ të tyre, osmanët e themeluan më 1455 vilajetin e Vukut (vilajetin e Vëllk), i cili përfshinte pjesën më të madhe të tokave të Kosovës. Krahinat tjera të regjistruara po më 1455, përfshiheshin në haset e Isa bej Ishakoviqit, të organizuara më vilajetet e Shkupit, të Zveçanit, të Jelleçit, Sjenicës etj.

Rëndësi jetike për ekzistencën e Perandorisë Osmane në tokat e pushtuara ishte vendosja e sistemit të timareve, e cila është edhe kryetema e studimit të prof. Rizvanollit. Në fakt, fillimi i shek. XVI shënon vendosjen e plotë në tokat shqiptare të sundimit e regjimit feudal-ushtarak osman, i cili ngrihej mbi sistemin e timarit. Pikërisht, në vitin 1506 u bë një regjistrim i përgjithshëm i të gjitha tokave shqiptare. Ato u përfshinë në dy zona të mëdha. Në njërin zonë bënë pjesë tokat, ku ishte zbatuar sistemi i timarit. Kjo quhej ndryshe zona e së dhjetës (*yshyrit*), kurse zona tjetër përfshinte krahinat malore të vetëqeverisura, ku nuk u zbatua sistemi i timarit. Ato i jepnin pushtetit qendror një taksë (haraç) fikse, prandaj quheshin zona e haraçit. Gjatë shtjellimit të kësaj tematike, mbështetur në burime të shumta, literaturë dhe regjistra të ndryshëm osmanë, autori konstaton se zona e timarit ishte e shtrirë në pjesën më të madhe të tokave shqiptare dhe kaloi në dy faza: në atë të lulëzimit, që përfshin shek. XVI

dhe atë të rënies, që përfshinë shek. XVII deri në mesin e shek. XIX. Edhe në shek. XVI-XVIII vazhduan të ekzistonin tri lloje feudesh të ngritura mbi pronësinë shtetërore të tokës, të cilat në varësi nga shuma e të ardhurave që jepnin, u quajtën *hase*, *ziamete* dhe *timare*.

Megjithatë, pronësia mbi tokën, që i përkiste shtetit osman edhe në trevat shqiptare, del se pati tri forma të ndryshme: tokat shtetërore që zinin sipërfaqen më të madhe të vendit dhe përbënin bazën e sistemit të timareve, tokat në zotërim privat (*erazi mylk*) që zotëroheshin nga pjesëtarë të aristokracisë feudale dhe tokat vakëf (*erazi vakf*), që ishin pronë e institucioneve fetare myslimane. Megjithatë, pjesa më e madhe dhe më e rëndësishme e tokave shqiptare i takonte formës së tokave shtetërore apo *mirie*. Këto përbënin fondin e tokave të përfshira në sistemin e timarit, në disa kategori: në radhë të parë, bënë pjesë tokat e punueshme, arat, livadhet në zotërim të fshatarëve. Tipar dallues i këtyre tokave (*rajatike*) ishte fakti se fshatarët që i zotëronin ato, ishin të detyruar t'i shlyenin një varg detyrimesh, si spahiut dhe shtetit. Legjislacioni nuk lejonte ndryshimin e statusit të tyre dhe ruante dallimin fetar midis bashtinës dhe çifligut. Në rast se një mysliman merrte një bashtinë, i shlyente detyrimet si i krishterë. E veçanta e tokës *mirie* ishte se ajo nuk mund të shitej, pra mund të jepej vetëm në shfrytëzim.

Një çështje me mjaft rëndësi që ka tërhequr gjithnjë e më tepër vëmendjen e autorit të këtij studimi është *Institucioni i spahinjve të krishterë*, i cili lindi dhe u zhvillua bashkë me lindjen dhe zhvillimin e Perandorisë Osmane, e cila, që në ditët e para të ekzistencës së saj, përfshiu në radhët e klasës së saj sunduese të gjitha shtresat e aristokracisë feudale vendëse, pa marrë parasysh përkatësinë fetare apo etnike të tyre. Në këtë drejtim, autori i kushton rëndësi të veçantë çështjes së origjinës, pozitës ekonomike, politike dhe juridike të spahinjve të krishterë dhe rolit të tyre gjatë depërtimit osman dhe në vitet e para të sundimit të tij në Kosovë.

Pas trajtimit të gjerë dhe krahasimit të mendimeve të autorëve që janë marrë me këtë problematikë, prof. Rizvanolli konkludon se në radhët e klasës sunduese të spahinjve kishte mjaft feudale vendës të krishterë ashtu siç kishte edhe në radhët e klasës së shtypur rajës mjaft myslimanë. Kjo tregon qartë se përkatësia klasore në vitet e para të themelimit dhe të zgjerimit të Perandorisë Osmane nuk është përputhë absolutisht me përkatësinë fetare. Shkaqet për të cilat fituan timare spahinj të krishterë në Kosovë ishin të shumta, përgjithësisht të njohura, të përcaktuara nga parimet e përgjithshme të sistemit të timareve, të cilat vlenin edhe për

spahinjtë myslimanë. Arsyeja kryesore për të cilin e shfrytëzonin timaret spahinjtë e krishterë ishte kryerja e shërbimit ushtarak. Zotëruesi i timarit merrte pjesë në ekspeditat ushtarake personalisht ose bashkë me një numër të caktuar ushtarësh dhe armatimesh varësisht nga sasia e të ardhurave të timarit, të cilin e shfrytëzon.

Në përfundim, theksojmë se përgatitja dhe botimi i studimit *Vendosja e sistemit të timarit në Kosovë në gjysmën e dytë të shekullit XV*, vjen si falënderim dhe homazh për punën kolosale të profesorit të ndjerë Masar Rizvanolli dhe kontributin e tij në edukimin e gjeneratave të shumta në fushën e historisë.

Gjon BERISHA